

VENDIM
Nr. 455, datë 22.5.2013

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 413, DATË 11.7.2007 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË
PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI
MINISTRISË SË BRENDSHME (DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË REZERVAVE TË
SHTETIT), TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 15 të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në listën që i bashkëlidhet vendimit nr. 413, datë 11.7.2007 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, përmasat e pronës “Agjencia Shijon” zëvendësohen me përmasat e përcaktuara në formularin 1 dhe genplan, me sipërfaqe totale 34 713 (tridhjetë e katër mijë e shtatëqind e trembëdhjetë) m², që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe përbëhet nga 2 (dy) fletë.

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha